

ABSTRAKT

Në këtë punim trajtohet dhe analizohet martesë në përgjithësi në këndvështrimin e të drejtës pozitive në Kosovë dhe të drejtës së Sheriatit. Martesa është institucioni juridik më i lashtë dhe më i rëndësishëm shoqëror dhe juridik. Martesa është bashkëjetesa ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Ajo është bazë e familjes dhe ka për detyrë të kryejë funksione të shumta shoqërore, në ngritjen dhe vetëdijesimin e brezave të rinj, rregullohet kryesisht me dispozita urdhëruese. Martesa ka rëndësi të madhe dhe disa qëllime kryesore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është shqyrtimi dhe analizimi i kushteve ligjore dhe procedurës për lidhjen e martesës sipas legjislacionit pozitiv të Kosovës dhe të Sheriatit. Përkatësisht, punimi ofron informacione të rëndësishme në lidhje me nocionin e martesës, kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës, pengesat dhe ndalesat martesore, për karakteristikat dhe rrjedhën e zhvillimit të procedurës për lidhjen e martesës, po ashtu diskutohen të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve si dhe marrëdhëniet pasurore të tyre. Përveç aspektit teorik në këtë punim gjithashtu trajtohet edhe aspekti praktik, ku janë të paraqitura statistikatat e kurorëzimeve të lidhura gjatë vitit 2019.

Për realizimin e qëllimit të tij, punimi është mbështetur kryesisht në këto metoda: metodën historike, metodën juridike, metodën e studimit të rasteve individuale, metodën doktrinare (*përshkruese*), metodën e krahasimit, metodën statistikore, evidencën statistikore dhe metodën sociologjike. Mirëpo metoda bazë e punimit konsiston në trajtimin krahasimor të institutit të martesës sipas të drejtës Pozitive të Kosovës dhe të drejtës së Sheriatit.

Në përfundim të këtij punimi është nxjerrë konkludimi që legjislacioni pozitiv në Kosovë i kushton një rëndësi të veçantë rregullimit të institutit të martesës, si dhe bazuar në statistikatat e kurorëzimeve të lidhura shohim se çdo vit kemi rritje të lidhjes së tyre.

Fjalët kyçe: martesë, procedurë, dispozita ligjore, bashkëshort, etj.

ABSTRACT

This paper deals with and analyzes marriage in general in terms of positive law in Kosovo and Sharia law. Marriage is the oldest and most important social and legal institution. Marriage is legal cohabitation which relies on the moral and legal equality of spouses. It is the basis of the family and has the duty to perform numerous social functions, in raising awareness of the younger generations; it is mainly regulated by imperative provisions. Marriage is of great importance and has some major goals. The main aim of this paper is to review and analyze the legal conditions and procedure for entering into marriage according to the positive legislation of Kosovo and Sharia. Respectively, the paper provides important information about the notion of marriage, conditions of marriage and its validity, obstacles and prohibitions of marriage, about the characteristics and the course of marriage procedure; it also discusses the rights and obligations of spouses as well as their property relations. In addition to the theoretical aspect, this paper also deals with the practical aspect, which presents related marriage statistics during 2019. To achieve its purpose, the paper is based mainly on the following methods: historical method, legal method, method of studying individual cases, doctrinal (descriptive) method, comparison method, statistical method, statistical evidence and sociological method. However, the basic method of work coincides in the comparative treatment of the institution of marriage according to the Positive law of Kosovo and Sharia law.

At the end of this paper it is concluded that the positive legislation in Kosovo pays special attention to the regulation of the institution of marriage, and based on the statistics of related marriages we see that every year we have an increase in this relation.

Keywords: marriage, procedure, legal provisions, spouse, etc.